



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME, KORÇË

Nr. 90 prot

Korçë më 20.2.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar : Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun
Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësimdhënës me kohë të plotë për "Lëndët Veterinare".

Mësues i kulturës profesionale lëndët teorike "Veterinari"

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- g) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- h) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- i) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- j) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- k) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- l) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet te plotesoje Kriteret e posaçme si vijon:

- e) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose te barazvlefshem me te ne të njëjtën fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- d) Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

2. Dosja e aplikimit , e cila permban dokumentacionin e kerkuar , sipas njoftimit te vendit te lire, duhet te perfshije :
- a) letër motivimi për pozicionin;
 - a) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 te ketij udhezimi
 - b) kartën e identitetit.
 - c) diplomën
 - d) librezën e punës;
 - e) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
 - f) çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - g) vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
 - h) vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
 - i) vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
 - j) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të tyre të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorezohen ne protokollin e ofruesit te AFP-se brenda dates.....06.03.2024



KATIANA MIRO
DREKTOR I SHKOLLËS